



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### “HASAN PRISHTINA”

Rr. "George Bush", p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Phone: +383 38 244 183- 244 186, Email: rektorati @uni-pr.edu

Ref. nr. 4516 Prishtinë, dt. 21.09.2023

#### RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFISË/GJEOGRAFI
Tema e diplomës master	<b>Analiza e proceseve të shpatit në sektorin rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës</b> <b>(Analysis of slope processes in road segment Batushë-Rrasa e Kosharës)</b>
Kandidati	<b>Fjolla Neziri</b>
Mentori	Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 29.12.2022 Vendimi nr.: 9586

Në bazë të kërkesës së kandidatit **Fjolla Neziri** (11.9.2023, ref.nr.:4147) dhe me lejen e mentorit të temës, komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të temës master, paraqet këtë:

#### RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT

Punimi i diplomës master me titull ” **Analiza e proceseve të shpatit në sektorin rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës**” (**Analysis of slope processes in road segment Batushë-Rrasa e Kosharës**) i kandidatës **Fjolla Neziri** paraqet një kontribut në trajtimin e proceseve të jashtme gjeologjike, ndërsa në departamentin e gjeografisë është ndër temat e para që trajton këtë problematikë. Analizat e proceseve të jashtme gjeologjike, me theks të veçantë e proceseve të shpatit ka rëndësi të madhe, ku qëllimi përfundimtar është identifikimi, analiza, trajtimi dhe në fund rekomandimi për të mbrojtur infrastrukturën apo njerëzit në përgjithësi.

Gjatë punë së saj, kandidatja Fjolla Neziri duke përdorur vërtetimin si një nga fazat e para të mbledhjes së informacioneve në terren, ka identifikuar proceset kryesore të shpatit, ndërsa me anë të matjeve duke përdorur klinometër ka analizuar pjerrësinë e shpateve, ndërsa nga hartat gjeologjike

dhe vrojtimet në terren ka analizuar shkëmbinjtë kryesorë të zonës si dhe raportet me tektonikën e zonës. Përveç tjerash, me qëllim të plotësimit të hulumtimit të saj, ka përdorur hartat gjeologjike e tektonike, imazhet satelitore të viteve të ndryshme, me ç'rast ka paraqitur ndryshimet e proceseve të shpatit në aspektin kohor dhe hapësinor.

Përveç identifikimit të proceseve të shpatit, kandidatja ka analizuar edhe faktorët e tjerë të cilët ndikojnë në stabilitetin e shpateve, duke përfshirë aspekte gjeologjike, tektonike, klimatike, bimore e antropogjene, me ç'rast në mënyrë gjithëpërfshirëse i ka paraqitur në dorëshkrim.

Hulumtimin e ka ndarë në dy faza: faza e parë e shqyrtimit të literaturës dhe e dyta në identifikimin e faktorëve kryesorë të nxitjes së proceseve të shpateve.

Përveç pjesës hyrëse ku kandidatja trajton aspekte gjeografike të segmentit rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës, në pjesën e diskutimit, ajo trajton 4 lëvizje të masave shkëmbore të cilat janë më të theksuara në këtë segment rrugor. Ajo identifikon shpatet me pjerrësi 35-40° si shpate më të ndjeshme ndaj proceseve të shpateve, me ç'rast janë paraqitur shembjet dhe rrëshqitjet. Duke përdorur teknika të GIS/RS ajo, në mënyrë interdisiplinare ka analizuar të gjithë faktorët e mundshëm që nxisin rrishtjen e paraqitjes së këtyre dukurive, dhe në mënyrë hartografike ka paraqitur identifikuar zonat me potencial të rrezikut. Terreni ku janë këto procese është kryesisht me thyerje, shkëmbinjtë të paçimentuar, andaj, paqëndrueshmëria e shpateve ishte më e theksuar.

Kandidatja arrin në përfundim se në sektorin rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës paraqiten dukuri të shpateve, ndër të cilat ndodhen tri rrëshqitje me përmasa të ndryshme, prej të cilave dy janë të lidhura me struktura tektonike e gjeologjike, si dhe prania e rrjedhave ujore. Rrjedhat ujore po ashtu kanë ndikuar në paqëndrueshmërinë e shpateve. Rasti i tretë ndërlidhet me përbërjen gjeologjike, duke u paraqitur në shkëmbinj ranorë të paçimentuar e të thyer. Shembja e masave shkëmbore është paraqitur nga faktori antropogjen, ku gjatë gjurmimit në bregoren e Shkozës është përshpejtuar destabilizimi i shpatit. Kandidatja përveç tjerash analizon relacionet e tektonike në proceset e shpatit.

Kandidatja ka vërejtur në hulumtimin e saj se në lëvizjet e masave shkëmbore hasen edhe lëvizjet e ngadalshme në disa lokacione, ku lëvizjet ndodhin për shkak të gravitetit, ku edhe prania e ujit ndihmon në proces.

Në fund, kandidatja duke u bazuar në hulumtimin e saj në terren dhe analizën teorike të proceseve të shpatit, jep disa rekomandime, që në rastin konkret, duhet të bëhet vlerësim gjeologjik, të mendohet planifikimi i përdorimit të tokës (land use), të ndërmerren masa për stabilizimin e shpateve, të bëhet projektimi i infrastrukturës, të vlerësohet ndalimi i nxjerrjes dhe thyerjes së gëlqerorëve, të analizohet mbrojtja dhe ruajtja e pyjeve, si dhe të bëhet monitorimi i vazhdueshëm.

Dorëshkrimi përmban një numër të konsiderueshëm të hartave, ilustrimeve, profileve, fotografive të terrenit që në mënyrë koncize tregojnë aftësinë e kandidatës për të paraqitur proceset

dhe dukuritë e shpateve si dhe përdorimin e teknikave të GIS/RS në gjeografi fizike e gjeologji, me anë të të cilave ka arritur rezultate të vlefshme.

## KOKLUZIONI DHE PROPOZIMI

Nga vlerësimi i dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatës **Fjolla Neziri**, me titull “**Analiza e proceseve të shpatit në sektorin rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës**” (**Analysis of slope processes in road segment Batushë-Rrasa e Kosharës**) mund të nxirren këto konkluzione:

- Tematika e përzgjedhur për të hulumtuar lëvizjet e masave shkëmbore në kuadër të infrastrukturës rrugore apo kudoqoftë është origjinale e me interes të përgjithshëm dhe shërben si bazë e mirë për studime të mëtejshme;
- Nga vrojtimet dhe analizat e bëra në terren, duke përdorur metodat dhe teknikat bashkëkohore (MDR, harta topografike, harta gjeologjike-tektonike, imazhe satelitore etj.), i kanë mundur për të ardhur deri tek rezultatet e pritura;
- të dhënat e paraqitura kanë rëndësi praktike, në veçanti për të kuptuar lëvizjet e masave shkëmbore dhe proceset e shpateve në përgjithësi, ndërsa rekomandimet e dhëna mundësojnë vlerësim të mirëfilltë dhe monitorim të vazhdueshëm të këtyre dukurive, të cilat në raste të caktuara mund të jenë fatale për njerëz e me dëme të mëdha për infrastrukturën.

Mbështetur në vlerësimet dhe konkluzionet e lartpërmendura, komisioni profesional-shkencor vlerëson se punimi i masterit i kandidatit **Fjolla Neziri**, me titull “**Analiza e proceseve të shpatit në sektorin rrugor Batushë-Rrasa e Kosharës**” (**Analysis of slope processes in road segment Batushë-Rrasa e Kosharës**) i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për të kaluar në procedim të mëtejshëm.

Prishtinë, më 19.9.2023

Komisioni:

1. Prof.dr. Arsim Ejupi, kryetar

2. Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi, anëtar (mentor)

3. Prof.dr. Gani Maliqi, (Universiteti i Mitrovicës), anëtar